



PARTITË POLITIKE

FINALIZOJNË LISTAT

PËR DEPUTETË, PAK RISI



Brenda një viti Kosova po hyn dy herë në zgjedhje për përfaqësuesit e saj në Kuvendin e Kosovës. Listat e partive për deputetë edhe kësaj here kanë pak risi. Atyre iu prinë liderët e partive, të cilët edhe janë kandidat për kryeministër.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar se të gjitha subjektet politike kanë dorëzuar listat gjatë ditës së fundit të afatit. Numri i përgjithshëm i kandidatëve që përfaqësojnë këto subjekte politike është 1,181 kandidatë

KOHA E DUHUR PËR MUNICIONE? KOSOVA FUTET NË LOJË



28 DHJETORI, MOMENTI I SË VËRTETËS: STABILITET APO STAGNIM?

Shkruan: Besnik VASOLLI, drejtor i Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare



AKTUALE



SIRIA SHËNON NJËVJETORIN E RRËZIMIT TË ASSADIT

SMAJL LATIFI BETOHET SI KRYETAR I RAHOVECIT PËR MANDATIN E TIJ TË KATËRT QEVERISËS

EKONOMI



SI OPEROJNË KOMPANITË E ELEKTROPRIVREDËS SË SERBISË ME SELI FIKTIVE NË KOSOVË?

BIZNESET TURKE SHPREHIN INTERESIM PËR BASHKËPUNIM ME AKB-NË DHE KOSOVËN

SPORT



BALLKANI SHKËPUTET NË KRYE TË TABELËS NË SUPERLIGË

RENOVA

PUTZ

Maqedoni

Xhepçisht –Tetovë

Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009

+389 44 487 755

Fax: +389 44 487 200

Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.P.K.

NDËRTIM

PROJEKTIM

SHITJE

INFO: 049-111-101,

044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051

044/367-061

028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com

info@kolegijbiznesi.com

030 500 878 | 045 500 878

044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A

DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,

Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,

E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri

+38344685122

Internet Website,

Marketing...

SIRIA SHËNON NJËVJETORIN E RRËZIMIT TË ASSADIT

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Presidenti i përkohshëm i Sirisë, Ahmed al-Sharaa, u bëri thirrje sirianëve që të punojnë së bashku për rindërtimin e shtetit të tyre, teksa shënojnë njëvjetorin e rrëzimit nga pushteti të sundimtarit Bashar al-Assad. Aleanca e udhëhequr nga islamistët e Sharas nisi një ofensivë në fund të nëntorit të vitit të kaluar, duke marrë kryeqytetin sirian, Damask më 8 dhjetor pas pothuajse 14 vjetësh luftë dhe duke i dhënë fund sundimit mbi pesëdekadësh të familjes Assad.

Pas lutjeve të mëngjesit në Xhaminë Umajad në Damask, Sharaa “lavdëroi sakrificat dhe heroizmin e luftëtarëve” që hynë në Damask, sipas një njoftimi të lëshuar nga Presidenca. “Faza aktuale kërkon bashkimin e përpjekjeve nga të gjithë qytetarët për të ndërtuar një Siri të fortë, për të konsoliduar stabilitetin e saj, për të mbrojtur sovranitetin e



saj dhe për të pasur një të ardhme që i përket sakrificave të popullit të saj”, tha Sharaa, i veshur me uniformë ushtarake, ashtu siç kishte bërë kur hyri në kryeqytet një vit më parë.

Qytetarët sirianë që nga fundi i nëntorit kanë shënuar përvjetorin e parë që nga fillimi i ofensivës, me festime që kulmuan të hënë në ngjarje në Damask, përfshirë një paradë

ushtarake dhe një fjalim të planifikuar nga Sharaa.

Sharaa, i cili është shkëputur nga e kaluara e tij xhihadiste, ka arritur të rivendosë statusin ndërkombëtar të Sirisë dhe ka arritur që të ketë lehtësim të sanksioneve për shtetin e tij.

Por, ai po përballlet me sfida të mëdha në garantimin e sigurisë, rindërtimin e institucioneve të shkatërruara, rikthimin e

besimit të sirianëve dhe ruajtjen e unitetit të shtetit të tij.

Përplasjet sektare në bastionet e minoriteteve alavite dhe druze të vendit, së bashku me operacionet e vazhdueshme ushtarake izraelite, e kanë lëkundur tranzicionin e brishtë të Sirisë.

Përmes një deklarate, sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, tha se “ajo që qëndron përpara është shumë më tepër se një tranzicion politik, është mundësia për të rindërtuar komunitete e shkatërruara dhe për të shëruar ndarjet e thella”. “Është një mundësi për të krijuar një komb ku çdo sirian, pa marrë parasysh etninë, fenë, gjininë ose përkatësinë politike, mund të jetojë në siguri, me barazi dhe me dinjitet”, tha ai, duke bërë thirrje për mbështetje ndërkombëtare.

Të shtunën, një udhëheqës i shquar shpirtëror i alavitëve në Siri u bëri thirrje anëtarëve të

këtij minoriteti fetar, ku bën pjesë edhe familja Assad, që të bojkotojnë festimet si shenjë proteste kundër autoriteteve të reja “shtypëse”.

Po ashtu të shtunën, administrata kurde që kontrollon pjesë të mëdha të verilindjes së Sirisë njoftoi një ndalim të tubimeve dhe ngjarjeve publike për të dielën dhe të hënë, duke u thirrur në arsye sigurie.

Sipas një marrëveshjeje të marsit, administrata kurde pritet të integrojë institucionet e saj në qeverinë qendrore deri në fund të vitit, por përparimi në këtë drejtim ka ngecur.

Udhëheqësi kurd, Mazloun Abdi, në një postim në X të dielën, rikonfirmoi angazhimin e kurdëve ndaj marrëveshjes, duke thënë se ajo është baza “për ndërtimin e një Siri demokratike, të decentralizuar... e forcuar nga vlerat e lirisë, drejtësisë dhe barazisë”.

PUTINI DHE MODI BISEDOJNË PËR TREGTINË DHE PAQEN NË TAKIMIN NË NJU-DELHI

NJU-DELHI, 5 DHJETOR - Presidenti i Rosisë, Vladimir Putin, dhe kryeministri i Indisë, Narendra Modi, i filluan bisedimet në takimin e tyre në Nju-Delhi të premten, duke folur për tregtinë mes vendeve të tyre dhe për paqen në Ukrainë.

India e priti liderin rus me tapet të kuq dhe Modi i tha atij se India i mbështet përpjekjet për paqe në Ukrainë. Kjo është vizita e parë e Putinit në Indi pas katër vjetësh, dhe synimi i tij është ta rrisë tregtinë me blerësin kryesor të armëve dhe naftës së transportuar përmes detit nga Rusia, në një kohë kur sanksionet perëndimore po ushtrojnë tryzni mbi lidhjet e tyre shumëvjeçare. Vizita po ndodh në një kohë kur Nju-Delhi është i angazhuar në bisedime me Shtetet e Bashkuara

për një marrëveshje tregtare që synon uljen e tarifave ndëshkuese të vendosura nga presidenti Donald Trump mbi mallrat indiane për shkak të blerjes së naftës ruse nga India.

Moska ka qenë furnizuesja e kryesor e armëve për Indinë prej dekadash dhe ka thënë se dëshiron të importojë më shumë mallra indiane në përpjekje për ta çuar tregtinë në 100 miliardë dollarë deri në vitin 2030, tregti e cila deri më tani ka qenë kryesisht në favor të Rosisë për shkak të importeve indiane të energjisë.

Qëkurse vendet evropiane ulën varësinë ndaj energjisë ruse pas pushtimit të Ukrainës pothuajse katër vjet më parë, India rriti blerjet e naftës ruse me zbritje, para se t'i ulte sërish këtë vit si



pasojë e trysnisë së tarifave dhe sanksioneve amerikane. “India nuk është neutrale, India ka një qëndrim, dhe ky qëndrim është për paqe”, i tha Modi Putinit në hapje të bisedimeve. “Ne mbështesim çdo përpjekje për paqe dhe qëndrojmë krah për

krah me çdo nismë të ndërmarrë për paqe”, shtoi ai.

Putini, në përgjigje, e falënderoi Modin për vëmendjen dhe përpjekjet e tij për ta gjetur një zgjidhje për konfliktin. “Ne patëm mundësi, dhe ju ma dhatë këtë mundësi, të flasim në hollësi për atë që po ndodh në drejtimin ukrainas dhe për hapat që po ndërmarrim së bashku me disa partnerë të tjerë, përfshirë Shtetet e Bashkuara, drejt një zgjidhjeje të mundshme paqësore të kësaj krize”, tha Putini.

“Ndërsa vendet dhe ekonomitë tona rriten, edhe mundësitë për bashkëpunim po zgjerohet”, shtoi ai.

India dhe Rusia pritet të nënshkruajnë një sërë marrëveshjesh në fund të

bisedimeve zyrtare.

Modi dhe Putini pritet të diskutojnë gjithashtu çështje që përfshijnë fuqinë punëtore dhe energjinë bërthamore civile.

Putini mbërriti në Indi një ditë pasi zhvilloi bisedime me të dërguarit kryesorë të Trumpit për një marrëveshje të mundshme paqeje për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë, por ata nuk arritën ndonjë kompromis.

India nuk ka pranuar ta dënojë Rusinë për luftën dhe ka bërë thirrje për paqe përmes dialogut dhe diplomacisë, ndërkohë që ka thënë se lidhjet e saj me Moskën janë vënë padrejtësisht në shënjestër nga vendet perëndimore, të cilat, sipas Indisë, kanë vazhduar të bëjnë biznes me Moskën kur ka qenë në interesin e tyre.

Hegseth: Gjermania, aleate shembull për shpenzime në mbrojtje

UASHINGTON, 8 DHJETOR - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth ka thënë se shih zhvillime pozitive në shpenzimet për mbrojtje në Gjermani dhe i ka lavdëruar aleatët e NATO-s për rritjen e buxheteve për ushtritë e tyre. Duke folur në një forum për mbrojtje në Kaliforni, Hegseth e ka mirëpritur marrëveshjen e NATO-s për t'i rritur ndjeshëm shpenzimet në mbrojtje në vitet në vijim. “Aleatët që shërbejnë si

shembuj, sikurse Izraeli, Koreja e Jugut, Polonia, Gjermania çdo ditë e më shumë, shtetet baltike dhe të tjerë, do të pranojnë trajtim special nga ne”, ka deklaruar ai.

Sipas tij, Shtetet e Bashkuara presin kontribute të ngjashme edhe nga aleatët tjerë, dhe se ata që dështojnë t'i përmbushin obligimet e tyre mund të përballen me pasoja. Marrëveshja e vendeve të NATO-s, e arritur në qershor - e nxitur nga lufta e Rosisë në

Ukrainë, dhe thirrjet e presidentit amerikan, Donald Trump - parasheh që vendet anëtare të shpenzojnë të paktën 3.5 për qind të bruto prodhimit të brendshëm (GDP) në mbrojtje, plus 1.5 për qind në projekte të lidhura me mbrojtjen, siç është infrastruktura.

Deri më 2035, shpenzimet në këtë sektor pritet të arrijnë në 5 për qind të GDP-së, njëherësh shifra më e lartë prej Luftës së Ftohtë.



KOHA E DUHUR PËR MUNICIONE? KOSOVA FUTET NË LOJË

Prodhimi i municionit e fut Kosovën në hartën e vendeve që ndërtojnë kapacitete mbrojtëse. Projekti mund ta forcojë sigurinë e Kosovës dhe bashkëpunimin me NATO-n, por njëkohësisht mund të ushqejë frikën e perceptuar në Ballkan, sipas disa ekspertëve. Respektimi i transparencës, sundimi i ligjit dhe lufta kundër korrupsionit konsiderohen thelbësore për ta bërë industrinë e mbrojtjes të besueshme dhe për të ruajtur mbështetjen e aleatëve

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Në Ballkan, ku balancat e sigurisë mbeten të brishta dhe veprimet shtetërore shpesh interpretohen përtej peshës së tyre reale, edhe hapat e vegjël marrin rëndësi të shtuar. Në këtë kontekst, prodhimi i municionit nga Kosova është një hap i kufizuar, por me potencial për të ndikuar në mënyrën se si vendi perceptohet në fushën e mbrojtjes.

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, konfirmoi se fabrika e parë e municioneve në Kosovë do të ndërtohet në Jahoc të Gjakovës, ndërsa prodhimi i parë pritet të dalë në fund të vitit 2026. Dhe, aktiviteti nuk do të ndalet me kaq. “Kjo zonë industriale do të shërbejë edhe për investitorë të tjerë, me të cilët jemi në kontakt dhe do të prodhojmë lloje të ndryshme të produkteve ushtarake - dronë ushtarakë dhe civilë ‘Made in Kosova’”, tha Kurti më 27 nëntor.

Marrëveshja për fabrikën u nënshkrua më 16 dhjetor, 2024, mes Qeverisë së Kosovës dhe prodhuesit shtetëror turk, MKE. Radio Evropa e Lirë nuk arriti të kontaktojë drejtpërdrejt me kompaninë, por, sipas një deklarate të saj nga tetori, Kosova do të pajiset me makineri për prodhimin e fishekëve dhe plumbave, një linjë prodhimi dhe montimi, laborator dhe pajisje testi. Personeli i MKE-së do të ofrojë edhe shërbime prodhimi, mirëmbajtjeje, riparimi dhe asistencë teknike për stafin kosovar.

I kontaktuar nga Radio Evropa e Lirë, një zyrtar i NATO-s në Bruksel nuk dha një vlerësim të drejtpërdrejtë për njoftimin e Kosovës se do të nisë prodhimin e municionit në vitin 2026, as për standardet specifike që vendi duhet t'i ndjekë, por u shpreh vetëm se “misioni i KFOR-it, i udhëhequr nga NATO-ja, mbetet i përqendruar në zbatimin e mandatit të OKB-së, duke ruajtur një mjedis të sigurt për të gjithë banorët e Kosovës, në çdo kohë, në mënyrë të paanshme dhe në koordinim të ngushtë me Policinë e Kosovës dhe misionin e BE-së, EULEX”.

NATO-ja nuk e ka mbështetur shndërrimin e FSK-së në ushtri - proces që pritet të përfundojë në

vitin 2028. Autoritetet e Kosovës, përfshirë Kurtin, thonë se ai po zhvillohet sipas standardeve të NATO-s dhe se armatimi i blerë gjatë katër vjetëve të fundit - në vlerë mbi 430 milionë euro sipas tij - vjen nga vende anëtare të aleancës: SHBA-ja, Turqia, Gjermania e të tjera. “Duke e rritur ushtrinë, e sigurojmë Republikën. Duke e ngritur Forcën e Sigurisë së Kosovës, e forcojmë partneritetin me aleatë”, tha Kurti.

Koloneli amerikan në pension, Ray Wojcik, e sheh vendimin e Kosovës për të prodhuar municione si një “iniciativë fantastike” - në linjë me pritjet e NATO-s që vendet aspiruese të zhvillojnë kapacitete industriale mbrojtëse. Në vlerësimin e tij, Kosova po e nis këtë prodhim në kohën e duhur: për të forcuar aftësitë e saj ende të kufizuara, për t'iu përgjigjur kërkesave më të larta të sigurisë pas luftës në Ukrainë dhe për të rritur bashkëpunimin rajonal me aleatët. “Një nga gjërat pozitive për Kosovën, falë pranisë shumëvjeçare të misionit të NATO-s, KFOR, është marrëdhënia e ngushtë dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me aleatët. Kosova e ka diskutuar këtë nismë veçanërisht me SHBA-në dhe Mbretërinë e Bashkuar - dy nga aleatët e saj më të afërt, të cilët janë shumë mbështetës për të”, thotë Wojcik për programin Expose të Radios Evropa e Lirë.

Wojcik, i cili ka shërbyer si udhëheqës i Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes në Ambasadën amerikane në Prishtinë, përmend edhe marrëveshjen rajonale të mbrojtjes mes Kosovës, Shqipërisë dhe Kroacisë, e cila, sipas tij, mbështet iniciativën për prodhimin e municioneve në Kosovë.

Argyro Kartsonaki, nga Instituti për Kërkime të Paqes dhe Politika të Sigurisë në Hamburg, pajtohet se është logjike që një shtet i vogël të përpiqet të forcojë sigurinë e vet, por paralajmëron, po ashtu, se këto veprime mund të perceptohen si kërcënim nga fqinjët, duke i rritur tensionet, në vend se t'i ulin ato. “Kjo nuk do t'i ndryshojë dinamikat e sigurisë në Ballkan. Ajo që mund të bëjë,



megjithatë, është t'i ushqejë narrativët. T'i japë edhe një element propagandës dhe diskurseve populiste të presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq. Nëse kjo pastaj ekzagjerohet, mund të krijojë frikë dhe pasiguri të perceptuar. Dhe, frika e perceptuar është po aq reale sa edhe kërcënimet e vërtetë. Pikërisht këtu qëndron edhe delikatesa e këtij vendimi”, thotë Kartsonaki për Exposenë. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, e ka interpretuar marrëveshjen e mbrojtjes mes Kosovës, Shqipërisë dhe Kroacisë si shenjë të një gare armatimi, duke theksuar se Serbia “do të mbrohet me sukses nga çdo agresor i mundshëm”.

Në të njëjtën linjë, kryetari i Komisionit parlamentar për Mbrojtje në Serbi, Milovan Drecun, ka pretenduar se fabrika turke e municioneve në Kosovë cenon sigurinë dhe pozitën e serbëve në vend, por pa sjellë prova konkrete për këtë.

Serbia, përndryshe, mbetet fuqia dominuese ushtarake në rajon, me një buxhet mbrojtjeje dukshëm më të lartë se ai i Kosovës dhe i vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor.

Sipas Institutit Ndërkombëtar të Kërkimeve për Paqen në Stokholm - SIPRI, Kosova në vitin 2024 ka ndarë rreth 162 milionë dollarë për mbrojtjen, ndërsa Serbia rreth 2.2 miliardë.

Serbia, po ashtu, mbetet eksportuesja kryesore e armëve dhe municioneve në rajon, duke përbërë mbi 65% të totalit të eksporteve, sipas Institutit për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta në Evropën Juglindore dhe Lindore (SEESAC). Pas saj renditen Bosnje dhe Hercegovina dhe vendet e tjera të rajonit, si Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Mali i Zi, të cilat eksportojnë gjithçka - nga municionet e lehta deri te minat dhe raketat.

Koloneli Wojcik thotë se Kosova duhet t'i adresojë perceptimet e Serbisë duke komunikuar qartë se iniciativat e saj të mbrojtjes,

përfshirë prodhimin e municioneve, synojnë t'i përmbushin standardet e NATO-s dhe të shërbejnë si mjet mbrojtës, jo si kërcënim. “Është një përpjekje për stabilitet rajonal, pasi mund të veprojë si mjet parandalues ndaj Serbisë agresive, e cila ka kapacitete të mëdha prodhimi armësh dhe municionesh. Prandaj, për një sasi shumë të vogël armësh ose municionesh që do të prodhojë Kosova, nuk ka arsye shqetësimi për serbët”, thotë Wojcik.

Se çfarë lloji dhe çfarë sasive municionesh synon të prodhojë Kosova, nuk dihet saktësisht, pasi një pjesë e madhe e informacionit në fushën e mbrojtjes është e klasifikuar. Në një deklaratë të mëhershme për Radion Evropë e Lirë, ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci - tani në detyrë - ka thënë se Kosova nuk mund të bëhet plotësisht e vetëqëndrueshme, por mund ta zvogëlojë varësinë nga vendet e tjera, duke prodhuar municione dhe armatime që përdoren më shumë dhe sigurohen më vështirë.

Kartsonaki, nga Instituti për Kërkime të Paqes dhe Politika të Sigurisë, thotë se Kosova, si një vend i vogël, nuk mund të zhvillojë një industri të madhe të mbrojtjes, pa kufizuar ndjeshëm buxhetin e saj për fusha të tjera të rëndësishme.

“Çështja është se ju keni një shtet të vogël, me nivele të larta të varfërisë dhe papunësisë. A është ky vërtetë investimi më i mirë që mund të bëni? Këtu nuk bëhet fjalë për Gjermaninë, e cila mund të prodhojë armë në një shkallë më të madhe, por, njëkohësisht, ka mjaft fonde për të mbuluar edhe aspektet sociale të shtetit”, thotë Kartsonaki.

Koloneli Wojcik thekson se buxheti i kufizuar i mbrojtjes e detyron Kosovën të veprojë me kujdes maksimal, duke investuar burimet në mënyrë të zgjuar. Ai nënvizon nevojën që përpjekjet në industrinë e mbrojtjes të koordinohen ngushtë me aleatët

kryesorë dhe të shmangen partneritetet që mund të dëmtojnë stabilitetin rajonal ose përafrimin me Perëndimin.

Për të qenë efektiv, ai thotë se sektori i mbrojtjes duhet të funksionojë sipas standardeve ndërkombëtare, duke përfshirë transparencën, sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit. “Mendoj se Kosova ka treguar rezultate të qëndrueshme. Shtetet e Bashkuara nuk do të kishin dhënë ndihmë për kaq shumë vite për sigurinë Kosovës, nëse do të kishte shqetësime për korrupsion në Ministrinë e Mbrojtjes. Kjo është një shenjë e mirë, dhe përpjekja për prodhimin e municioneve duhet të ndjekë të njëjtin model - duke u mbikëqyrur nga NATO-ja dhe partnerët kryesorë, si SHBA-ja dhe Mbretëria e Bashkuar. Ndaj, rreziku për keqmenaxhim është shumë i ulët”, thotë Wojcik.

Shtetet e Bashkuara kanë në Kosovë kampin Bondsteel, që shërben si baza më e madhe ushtarake amerikane në Ballkan. NATO-ja ka ende mbi 4.000 paqeruajtës - kryesisht në veri të vendit, ku, në dy vjetët e fundit, janë shënuar tensionet më të rënda etnike që nga shpallja e pavarësisë, më 2008.

Forca e Sigurisë së Kosovës është e armatosur lehtë, por që nga ardhja e Kurtit në pushtet në vitin 2021, buxheti i mbrojtjes ka shkruar duke u rritur.

Edhe në nivel global, të ardhurat nga industria e armëve janë rritur ndjeshëm gjatë vitit 2024 - nxitur nga shpenzimet e larta ushtarake për shkak të luftërave në Ukrainë dhe në Gazë, si dhe tensioneve gjeopolitike rajonale dhe globale. Sipas Institutit SIPRI, shitjet e armëve dhe shërbimeve ushtarake janë rritur për 5.9 për qind vitin e kaluar, duke arritur një rekord prej 679 miliardë dollarësh.

Me fjalët e kolonelit Wojcik, prodhimi i municioneve në Kosovë mund të jetë në dobi edhe të aleatëve të NATO-s, përfshirë Ukrainën.



PARTITË POLITIKE FINALIZOJNË LISTAT PËR DEPUTETË, PAK RISI

Brenda një viti Kosova po hyn dy herë në zgjedhje për përfaqësuesit e saj në Kuvendin e Kosovës. Listat e partive për deputetë edhe kësaj here kanë pak risi. Atyre iu prinë liderët e partive, të cilët edhe janë kandidat për kryeministër. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar se të gjitha subjektet politike kanë dorëzuar listat gjatë ditës së fundit të afatit. Numri i përgjithshëm i kandidatëve që përfaqësojnë këto subjekte politike është 1,181 kandidatë

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Partitë politike në Kosovë kanë finalizuar listat e kandidatëve për zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të 28 dhjetorit dhe kanë publikuar emrat përmes të cilëve synojnë të sigurojnë përfaqësimin e tyre në legjislaturën e re të Kuvendit, pa ndonjë risi në përbërjen e ekipeve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar se të dielën në mesnatë është përmbyllur afati për subjektet politike për dorëzimin online të listave të tyre me emrat e kandidatëve për deputetë për t'u certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Gjatë periudhës 14-ditore (24 nëntor - 7 dhjetor 2025, 23:59) 24

subjektet politike kanë dorëzuar listën me emrat e kandidatëve për deputetë. Pothuajse të gjitha subjektet politike kanë dorëzuar listat gjatë ditës së fundit të afatit. Numri i përgjithshëm i kandidatëve që përfaqësojnë këto subjekte politike është 1,181 kandidatë. Në përmbushje të detyrimeve ligjore lidhur me përshtatshmërinë/aftësinë e kandidatëve për t'u certifikuar, KQZ, nëpërmjet Zyrës, do të dorëzojë në disa institucione kërkesat e veçanta së bashku me listën e kandidatëve që duan të certifikohen për pjesëmarrje në zgjedhje, me qëllim të verifikimit të tyre nëse janë në përputhje me nenin 30 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Top dhjetë pretendentët e Lëvizjes Vetëvendosje, përveç kryetarit të partisë, Albin Kurti, i

RENDITJA E SUBJEKTEVE POLITIKE NË FLETËVOTIMIN E ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME PËR KUVENDIN E KOSOVËS:

- 111 Nova Demokratska Stranka
- 112 Kosova Demokratik Türk Partisi - KDTP
- 113 Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar
- 114 Fjala
- 115 Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës
- 116 Lëvizja Vetëvendosje!
- 117 Iniciativa Qytetare Për Kosovë
- 118 Jedinstvena Goranska Partija
- 119 Nedžmidin Sejdilar - Kandidat i pavarur
- 120 Partia Liberale Egjiptiane
- 121 Kosovski Savez
- 122 Nisma Socialdemokrate - Nisma
- 123 Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK
- 124 Kosovaki Nevi Romani Partia
- 125 PAI-PDAK-LPB
- 126 Socjaldemokratska Unija - SDU
- 127 Srpska Lista
- 128 Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës
- 129 Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës - AAK
- 130 Partia Demokratike e Kosovës - PDK
- 131 PSA - Iniciativë Qytetare
- 132 Koalicija Vakati
- 133 Partia Rome e Bashkuar e Kosovës
- 134 Za Slobodu Pravdu i Opstanak

cili i prin listës, janë Glauk Konjufca, Donika Gërvalla-Schëarz, Avni Dehari, Albulena Haxhiu, Xhelal Sveçla, Mimoza Kusari, Hajrulla Çeku e Shqipe Selimi. Risi është fakti që Andin Hoti, ish-deputet i PDK-së dhe kryetar

i Komisionit Qeveritar për të Pagjeturit, iu bashkua LV-së. Ai po ashtu ishte emër i propozuar për ministër në dy tentativat e LV-së për formimin e Qeverisë me rezultatet e 9 shkurtit. Në këto zgjedhje po ashtu garojnë edhe analistët politikë Viktor

Buzhala dhe Blerim Gashi si të posa aderuar në GUXO. Partia Demokratike e Kosovës ka publikuar gjithashtu listën e 110 kandidatëve që garojnë për deputetë në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare, duke synuar të sjellë “energji të re, profesionalizëm dhe qasje moderne” në skenën politike të Kosovës. Në anën tjetër, PDK-ja ka përfshirë në listën e saj ish-deputetët e LV-së, Eman Rrahmani dhe Visar Korenica, të cilët në zgjedhjet e kaluara garuan me “Listën për Familjen”. Në dhjetëshen e PDK-së, përpos kryetarit të partisë dhe kandidatit për kryeministër, Bedri Hamza, renditen Uran Ismaili, Vlora Çitaku, Enver Hoxhaj, Arben Mustafa, Besa Kabashi Ramaj, Rahman Rama, Eman Rrahmani, Sala Jashari e Kujtim Gashi. PDK-së iu bashkuan gjithashtu ish-drejtori i Administratës Tatimore, Ilir Murtezaj, profesori universitar Gëzim Qerimi, doktori Adriatik Berisha, kandidati për kryetar të Mitrovicës së Jugut, Arian Tahiri dhe ish-kryetari i Zubin Potokut, Izmir Zeqiri. Në krye të listës së Lidhjes Demokratike të Kosovës qëndron Lumir Abdixhiku, pasuar nga Kujtim Shala, Hykmete Bajrami, Doarsa Kica

HAMZA I KËRKON BE-SË T'I HEQ SANKSIONET PAVARËSISHT SE KUSH DO TA UDHËHEQË KOSOVËN

EPOKA
ERE


Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ia ka dërguar një letër zyrtare Presidentes së Komisionit European, Ursula von der Leyen, ku kërkon heqjen e menjëhershme dhe të pakushtëzuar të masave të BE-së ndaj Kosovës.

Në tekstin e letrës bie në sy një qasje që shkon përtej interesit partiak dhe zgjedhor, duke e vendosur perspektivën europiane të Kosovës mbi çdo rivalitet politik.

Në qendër të mesazhit të tij, Hamza thekson se Kosova duhet trajtuar si çdo vend tjetër i Ballkanit Perëndimor, duke theksuar se sanksionet po e dëmtojnë vendin në momente kyçe për integrimin europian dhe euroatlantik. “Vendit tonë duhet t’i jepen të njëjtat mundësi, mjete dhe mbështetje si të gjitha vendet tjera të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt BE-së dhe NATO-s”, shkruan ai.

Duke reflektuar mbi vitin sfidues që ka kaluar Kosova, me tri procese zgjedhore brenda një viti, Hamza shpjegon se këto janë dëshmi të “qëndrueshmërisë dhe



pjekurisë së demokracisë së Kosovës”.

Ai thotë se proceset zgjedhore janë zhvilluar “demokratikisht, me transparencë dhe paqësisht”, pavarësisht bllokadës së

mëvonshme politike.

Në letrën e tij, Hamza risjell në vëmendje sakrificat dhe obligimet që Kosova ka marrë përsipër në rrugën e integritit, përfshirë edhe krijimin e

Dhomave të Specializuara. Ai e quan këtë një kërkesë të imponuar vetëm mbi Kosovën, e cila “fatkeqësisht është shndërruar në një instrument monoetnik”.

Por, pjesa më shprehëse e letrës është thirrja e tij për unitet dhe qasje të përbashkët shtetërore ndaj interesave strategjike. “Pavarësisht se kush do t’i udhëheqë institucionet e Kosovës pas zgjedhjeve, vendi ynë duhet të ketë të njëjtat mjete dhe mbështetje si të gjitha të tjerat në rajon. Vazhdimi i masave e privon Kosovën nga këto mundësi dhe rrezikon të minojë vlerat demokratike dhe pro-evropiane”.

Kjo fjali e përmbledh filozofinë e letrës: çështja e sanksioneve nuk është e një qeverie apo partie, por e vetë shtetit të Kosovës.

Në përmbyllje, Hamza i bën thirrje BE-së që të dërgojë një sinjal të fortë mbështetjeje ndaj qytetarëve të Kosovës, duke kërkuar vendimin që do t’i hapte rrugë një faze të re të marrëdhënieve. “Kërkoj me respekt heqjen e menjëhershme dhe të pakushtëzuar të të gjitha masave të BE-së ndaj Kosovës”. Letra reflekton një pozicion që Hamza e paraqet jo vetëm si lider partie, por edhe si një figurë burrështetasi që synon stabilitet, partneritet dhe trajtim të drejtë të Kosovës në proceset euroatlantike.

Oficeri i FSK-së diplomon në ShBA

Prishtinë, 8 dhjetor- Kapiten Ymërdin Hasani ka diplomuar në Kursin e Çështjeve Civile në Fort Bragg, Karolina e Veriut, ShBA, në Qendrën dhe Shkollën e Luftës Speciale John F. Kennedy.

Kapiten Hasani është shpërblyer me Medaljen për Arritje Ushtarake e cila i ndahet pjesëtarëve të cilët kanë shfaqur rezultate të larta gjatë trajnimit. Ky trajnim i

specializuar përqendrohet në përgatitjen e oficerëve për bashkëpunim me komunitete lokale, vlerësim të nevojave civile dhe koordinim të projekteve që mbështesin stabilitetin dhe zhvillimin në zona operimesh.

Përmes këtij kursi, Kapiten Hasani ka fituar njohuri të avancuara në menaxhimin e situatave civile, bashkërendimin me institucione vendore dhe

organizata partnere, si dhe në ndërtimin e urave të bashkëpunimit ndërmjet forcave ushtarake dhe popullsisë civile.

Kapiten Hasani do t’i kthejë njohuritë e përfituara në shërbim të Kosovës, duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve të Çështjeve Civile në Forcën e Sigurisë së Kosovës.



Xhelili e Anton Quni. E pjesë e dhjetëshes janë edhe Lutfi Haziri, Avdullah Hoti, Jehona Lushaku e Ukë Rugova.

Pjesë e listës së LDK-së është edhe ish-ministri i Shëndetësisë, Ferid Agani.

Një prej rugovistëve të parë, ish-kryetari i Podujevës, Agim Veliu, i pakënaqur me vendimin për të mbetur edhe kësaj radhe jashtë listës, e ka cilësuar këtë si “një padrejtësi të pashembullt”.

Ramush Haradinaj kryeson listën e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Në dhjetëshen e parë të AAK-së figurojnë Besnik Tahiri, Time Kadriaj, Bekë Berisha, Arbër Tolaj, Albana Bytyqi, Pal Lekaj, Gani Dreshaj, Diellza Kukaj e Agim Çeku.

Nisma Socialdemokrate, që këtë herë garon e vetme, ka kryetarin Fatmir Limaj dhe Xhevahire Izmakun në dy vendet e para. Më pas vijnë Arbëreshë Krasniqi, Mevludin Krasniqi,

Endrit Shala, Albulena Balaj Halimaj, Artan Nimani, Çerkin Dukolli, Jehona Rrafshi Lumi dhe Nexhat Mustafa.

Limaj ka bërë me dije se nëse partia e tij kalon prapun zgjedhor, do t’i bashkohet Grupit Parlamentar të PDK-së, duke synuar stabilitet dhe bashkëpunim paszgjedhor.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare do të mbahen më 28 dhjetor 2025. Zgjedhjet e kaluara parlamentare u mbajtën më 9 shkurt 2025, mirëpo pavarësisht përpjekjeve për gati një vit, vendi mbeti në bllokadë pa institucione të reja.

Kosova vazhdon të funksionojë me Qeveri kujdestare që nga muaji mars 2025. Në zgjedhjet e 9 shkurtit, LV-ja doli e para me 396,787 vota apo 42.30%, PDK-ja e dyta me 196,474 apo 20.95%, LDK-ja e treta me 171,357 apo 18.27%, koalicioni që më pas u nda, AAK-Nisma me 66,256 vota apo 7.06%.

KQZ: Mbi 70 mijë votues të regjistruar nga diaspora për zgjedhjet e 28 dhjetorit

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në Kosovë i ka miratuar mbi 70 mijë aplikime për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit. Lajmin e ka konfirmuar zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi. “Sipas të dhënave preliminare, gjatë periudhës 11-ditore (26 nëntor - 6 dhjetor) përmes platformës

elektronike të KQZ-së, janë pranuar mbi 84.700 aplikime për regjistrim për votim jashtë Kosovës, prej të cilave janë aprovuar rreth 71.900 ndërkaq janë refuzuar rreth 6.700. Në vlerësim e sipër janë rreth 5.900 aplikime”, ka thënë Elezi në disa përgjigje me shkrim. Ai ka bërë të ditur se pjesa më e madhe e votuesve janë regjistruar për të votuar

përmes postës, mbi 51.000 sosh, për të dërguar pakon me fletëvotim në ndonjërin nga adresat e kutive postare jashtë Kosovës dhe rreth 2.500 të tjerë janë regjistruar për të dërguar pakon me fletëvotim në kutinë postare të KQZ-së në Kosovë. “Rreth 18.000 shtetas janë regjistruar për të votuar fizikisht në ndonjërin nga përfaqësitë diplomatike”, ka thënë mes tjerash Elezi.

Bizneset turke shprehin interesim për bashkëpunim me AKB-në dhe Kosovën

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka pritur të hënën në takim një delegacion të bizneseve nga Turqia, të udhëhequr nga Osman Servi, kryetar i UTSIAD-it në Stamboll Organizatë e Industrisë dhe Biznesit Turko-Ndërkombëtar.

Gjatë takimit u diskutua për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet bizneseve të Kosovës dhe Turqisë, me fokus në rritjen e investimeve, shkëmbimet tregtare dhe krijimin e partneriteteve të reja. Osman Servi theksoi se bizneset turke janë të

interesuara për bashkëpunim më të ngushtë me AKB-në dhe për të eksploruar mundësitë që ofron tregu i Kosovës. Ai u shpreh se ekziston potencial i madh për projekte të përbashkëta në sektorë të ndryshëm ekonomikë. Nga ana tjetër, Agim Shahini vlerësoi lartë gatishmërinë e

UTSIAD-it për bashkëpunim dhe shprehu përkushtimin e AKB-së për të lehtësuar lidhjen e bizneseve dhe për të krijuar ura të reja partneriteti ndërmjet dy vendeve. Takimi u mbyll me zotimin për vazhdimin e komunikimit dhe përgatitjen e hapave konkretë drejt realizimit të bashkëpunimeve të ardhshme.




28 DHJETORI, MOMENTI I SË VËRTETËS: STABILITET APO STAGNIM?

Shkruan: Besnik VASOLLI,
drejtor i Odës Ekonomike
Gjermano-Kosovare

Prej dhjetë muajsh, Kosova jeton në një situatë të pazakontë politike, ndërsa zgjedhjet e fundit megjithëse u organizuan në përputhje me standardet më të mira demokratike, nuk arritën të prodhojnë shumicën e nevojshme për formimin e institucioneve. Fragmentimi politik, mungesa e kompromisit dhe polarizimi i rritur sollën një realitet të ri: një bllokadë që e la Kosovën pezull, në një hapësirë të paqartë mes rezultatit të zgjedhjeve dhe pamundësisë për të ndërtuar një qeveri funksionale. Ky ngërç na çoi te shpallja e zgjedhjeve të reja më 28 dhjetor. Por këto zgjedhje nuk janë thjesht një përsëritje e procesit zgjedhor; ato janë një moment përcaktues për Kosovën. Janë një provë se sa jemi në gjendje të ndërtojmë konsensus rreth funksionimit të shtetit dhe të garantojmë stabilitetin që kërkon zhvillimi ekonomik dhe shoqëror. Këtë herë, Kosova nuk ka nevojë

vetëm për zgjedhje të organizuara mirë. Ajo ka nevojë për zgjedhje të pranuar nga të gjithë, për një rezultat që respektohet dhe që mundëson formimin e një qeverie të qëndrueshme. Sepse funksionimi i shtetit nuk varet vetëm nga korrektësia e ditës së votimit, por nga gatishmëria e aktorëve politikë për të bashkëpunuar dhe për të ndërtuar institucione që punojnë. Mosfunksionimi politik ka pasoja që shkojnë më thellë sesa duket në sipërfaqe. Çdo muaj pa qeveri sjell një faturë të qartë për vendin. Reformat ngadalësohen, projektet madhore mbeten pezull, ndërsa partnerët ndërkombëtarë humbasin qartësinë për drejtimin e vendit. Për një ekonomi të vogël si e jona, kjo sjellje politike ka kosto të mëdha. Sektori privat e ndien i pari dhe më së shumti këtë pasiguri. Kompanitë shtyjnë vendime të rëndësishme, projektet zhvillimore vonohen, investitorët e huaj bëhen më të rezervuar, ndërsa politikat fiskale, që mund të ndikojnë rritjen ekonomike, mbeten pezull.



Në klimë të tillë pasigurie, bizneset futen në një gjendje pritjeje. Ato hezitojnë të investojnë, shmangin planet afatgjata dhe presin me muaj atë që normalisht duhet të vendoset brenda javësh. Kapitali, veçanërisht ai i huaj, është i ndjeshëm ndaj mungesës së stabilitetit politik. Dhe kapitali, thjesht, shkon aty ku është më i sigurt. Kosova nuk mund të përballojë që të humbasë investime për shkak të një paqëndrueshmërie të zgjatur politike. Për më tepër, shteti vetë mbetet i kufizuar. Pa qeveri, buxhetet funksionojnë në mënyrë të përkohshme, investimet publike

kufizohen, marrëveshjet strategjike nuk ecin dhe besimi i partnerëve ndërkombëtarë dëmtohet. Një vend pa qeveri fuqiplotë është një vend me ritëm të ngadalësuar, dhe Kosova nuk ka luksin të humbasë kohë. Prandaj, zgjedhjet e 28 dhjetorit nuk janë vetëm një datë në kalendar. Ato janë një rast për reflektim, për të gjithë: për partitë politike, për shoqërinë civile, akademinë, mediat dhe qytetarët. Partitë duhet të tregojnë pjekuri, të mbajnë fushatë të përgjegjshme dhe ta respektojnë rezultatit. Institucionet zgjedhore duhet të garantojnë transparencë të plotë. Shoqëria civile dhe

akademia duhet të monitorojnë procesin dhe të informojnë publikun me profesionalizëm. E mbi të gjitha, qytetarët duhet të dalin dhe të votojnë, sepse vota e tyre është i vetmi instrument që mund ta thyejë ciklin e pasigurisë. Kosova nuk mund të lejojë që një palë tjetër zgjedhjesh të mos prodhojë qeveri. Kjo nuk është vetëm çështje e stabilitetit politik; është çështje e zhvillimit ekonomik, e funksionimit të institucioneve dhe e besimit të qytetarëve në shtetin e tyre. Është çështje e së ardhmes së Kosovës. Më 28 dhjetor, ne nuk po zgjedhim vetëm partitë që do të na qeverisin. Ne po vendosim nëse vendi ynë do të hyjë në vitin e ardhshëm me institucione funksionale apo me një ngërç të ri që ngadalëson zhvillimin dhe integrimin tonë evropian. Ky është momenti për të treguar pjekuri, unitet dhe përgjegjësi. Kosova ka nevojë për stabilitet. Ka nevojë për qeveri. Dhe këtë mund ta arrijmë vetëm nëse të gjithë, si politika, institucionet, bizneset, mediat dhe qytetarët e kryejnë rolin e tyre me seriozitet dhe integritet.

QENDRA PËR QËNDRIM DITOR PËR PERSONAT E MOSHUAR NË GJILAN AFËR FUNKSIONALIZMIT

Gjilan, 8 dhjetor- Punimet për ndërtimin e qendrës për qëndrim ditor për personat e moshuar, bujtinës për studentë dhe kuzhinës popullore në Gjilan, po shkojnë drejt mbarimit. Kanë mbetur edhe pak ditë, deri në lëshimin e saj në funksion për të moshuarit, shujta ditore për familjet në nevojë dhe strehim për studentë që do të

kenë mundësinë të banojnë. Për të për parë ecurinë e punimeve në këtë vend punishte, ishte kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, bashkë me humanistin Halil Kastratin nga organizata humanitare “Jetimat e Ballkanit”. Kryetari i Gjilanit, tha se së bashku me hoxhën dhe humanistin Halil Kastrati,



vizituan qendrën e re për të moshuarit, një projekt i rëndësishëm dhe i veçantë që

është në përfundim e sipër. “Për gjeneratat që kanë nevojë për mbështetje dhe kujdes po krijojmë një hapësirë të denjë dhe të sigurt”, tha Alban Hyseni. I pari i Gjilanit falënderoj përzemërsisht mikun tonë të çmuar, Halil Kastratin, për përkrahjen e vazhdueshme në këtë projekt. Nga ana tjetër humanisti Halil Kastrati, ka thënë se objekti në

Gjilan, po shkon drejt fazës finale. Ai tregoi se aty është: qëndrim ditor për të moshuar, bujtinë për student dhe kuzhinë humanitare. “Së shpejti do të presim shiritin e inaugurimit të këtij projekti, i bashkë financuar me Komunën e Gjilanit. Bamirës, Zoti kurrë mos ju humbë”, tha humanisti Halil Kastrati.

Smajl Latifi betohet si kryetar i Rahovecit për mandatin e tij të katërt qeverisës

RAHOVEC, 8 DHJETOR - Të hënën në seancën inauguruese të Kuvendit Komunal të Rahovecit, u bë betimi i anëtarëve të rinj të kuvendit, të

cilët morën detyrën për mandatin 2025-2029. Po ashtu, para kuvendarëve dhe qytetarëve, betimin e tij e dha edhe kryetari i Komunës së

Rahovecit, Smajl Latifi, duke shënuar kështu fillimin zyrtar të mandatit të tij të ri. Kuvendi Komunal zgjodhi edhe Kryesuesin e Kuvendit për

mandatin 2025-2029, duke finalizuar kështu strukturimin legjislativ për katër vitet e ardhshme, me 15 vota pro, 5 kundër dhe 7 abstenim.



SI OPEROJNË KOMPANITË E ELEKTROPRIVREDËS SË SERBISË ME SELI FIKTIVE NË KOSOVË?



PRISHTINË, 8 DHJETOR - Tri kompani të Elektroprivredës së Serbisë (EPS) - kompania shtetërore energjetike serbe - të regjistruara me seli në Kosovë, kanë borxhe që tejkalojnë gjysmë miliard euro. Termocentralet e Kosovës, Minierat Sipërfaqësore të Kosovës dhe Elektrokosmet renditen ndër 100 humbësit më të mëdhenj në Serbi, tregojnë raportet financiare të publikuara në Regjistrin Ekonomik të këtij vendi, të cilat i analizoi Radio Evropa e Lirë. Këto kompani, me adresa fiktive në Kosovë, vazhdojnë të operojnë edhe 25 vjet pasi Serbia humbi kontrollin mbi pasuritë dhe menaxhimin e sistemit energjetik të Kosovës. Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike janë në duart e kompanive kosovare, ndërsa këto tri kompani serbe, me mbi 3.100 të punësuar, veprojnë nga Beogradi. Të dhënat e Agjencisë për Regjistrat e Bizneseve të Serbisë (APR) tregojnë se ato vazhdojnë të akumulojnë borxhe, me një deficit total që kalon 580 milionë euro.

Çfarë bëjnë duke pasur parasysh që në Kosovë nuk operojnë?

Këto tri kompani, për Prishtinën zyrtare nuk ekzitojnë, sepse nuk njihen nga ligjet e Kosovës. Por, Beogradi zyrtar, i cili e kundërshton pavarësinë e Kosovës, vazhdon ta konsiderojë

veten si pronar të objekteve të sistemit elektroenergjetik në Kosovë. Mosmarrëveshjet pronësore, si dhe çështjet tjera që rëndojnë marrëdhëniet mes Prishtinës dhe Beogradit, janë tema të dialogut që zhvillojnë dy vendet, nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Ky proces, megjithatë, është i bllokuar prej vitesh dhe Marrëveshja e arritur për Energjetikën nuk zbatohet plotësisht. Raportet financiare, të disponueshme publikisht dhe të analizuar nga Radio Evropa e Lirë, tregojnë se tri ndërmarrjet - Termocentralet e Kosovës, Minierat Sipërfaqësore të Kosovës dhe Elektrokosmet - në fakt ofrojnë shërbime për Elektroprivredën e Serbisë. Punëtorët e tyre angazhohen kryesisht në punë të ndryshme ndihmëse brenda sistemit të EPS-it: nga remonti dhe mirëmbajtja e objekteve elektroenergjetike deri te leximi i njehsorëve në Serbi. Në raportet e tyre financiare thuhet, gjithashtu, se këto kompani punësojnë punëtorë, të cilët, pas luftës së vitit 1999, janë “dëbuar nga vendet e punës”, ndërsa vetë firmat janë “penguar” ta kryejnë veprimtarinë e tyre në sistemin energjetik të Kosovës. Edhe pse kanë humbje të akumuluara, këto tri ndërmarrje me adresa fiktive në Kosovë shpallin tenderë dhe u japin

punë kompanive të ndryshme private dhe shtetërore në Serbi. Vetëm në vitin 2025, ato kanë lidhur më shumë se 80 kontrata dhe marrëveshje me vlerë mbi 5 milionë euro, konstatoi REL-i, duke analizuar të dhënat zyrtare nga portali i prokurimeve publike. Për nevojat e këtyre ndërmarrjeve janë blerë, për shembull, automobila, kamionë, autobusë, karburante, makina, vegla dhe pajisje e materiale të ndryshme ndërtimore. Para janë shpenzuar edhe për telefona mobilë dhe pajisje kompjuterike. EPS-i dhe tri ndërmarrjet e tij vartëse me adresa në Kosovë nuk u janë përgjigjur pyetjeve të REL-it në lidhje me mënyrën e funksionimit të tyre. Përgjigje nuk ka as në pyetjet në lidhje me blerjen e mallrave dhe shërbimeve të ndryshme, duke pasur parasysh se ndërmarrjet nuk e kryejnë veprimtarinë e tyre bazë - prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike. Në shumë prej këtyre tenderëve, punët i kanë fituar kompani që nuk kanë pasur konkurrencë, sepse kanë qenë të vetmet që janë paraqitur me ofertë. “Kur nuk ka konkurrencë, linden dyshime për korrupsion”, vlerëson profesori në pension i Fakultetit Teknologjik-Metalurgjik në Beograd, Petar Gjukiq. REL-i pyeti edhe Qeverinë e Serbisë dhe Ministrinë e Energjisë atje se cili është plani

për ndërmarrjet e EPS-it me adresa në Kosovë, por, deri në publikimin e këtij artikulli, nuk mori përgjigje.

“Shpenzim i pastër”

Termocentralet e Kosovës, Minierat Sipërfaqësore të Kosovës dhe Elektrokosmet janë plotësisht të varura financiarisht nga kompania mëmë, Elektroprivreda. Dhe nuk janë të vetmet, pasi EPS-i është pronar edhe i disa kompanive të tjera vartëse në Serbi. “EPS-i ka në varësi ndërmarrje joproduktive dhe paratë brenda këtij sistemi po shpërdorohen”, vlerëson Gjukiq. Ndërmarrjeve me seli fiktive në Kosovë, EPS-i u transferon para për pagat e punonjësve dhe shpenzimet tjera të nevojshme, në mënyrë që ato të mund të funksionojnë. “Ata nuk janë të punësuar formalisht në EPS, por marrin të ardhura nga EPS-i”, shton Gjukiq. Sipas të dhënave nga raporti financiar i Elektroprivredës për vitin 2024, mbi 54.7 milionë euro janë shpenzuar vetëm për pagat e punonjësve të ndërmarrjeve me seli në Kosovë. Por, shpenzimet për paga nuk janë i vetmi fond që u transferohet atyre. EPS-i paguan edhe shërbimet ndihmëse brenda sistemit energjetik serb, në të cilat janë të angazhuara këto tri ndërmarrje. “EPS-i u jep punë që - me shumë gjasa - do të mund t'i kryente

edhe vetë”, thekson Gjukiq. Këshilli Fiskal i Serbisë, një organ i pavarur shtetëror që analizon të hyrat dhe shpenzimet publike, i përshkruan këto transfere për tri ndërmarrjet si “shpenzim i pastër”. “Prandaj, këto pagesa duhet të përjashtohen nga bilanci i EPS-it, pasi ato nuk përfaqësojnë shpenzime të aktivitetit të vetë kompanisë, por një lloj ndihme sociale”, ka vlerësuar Këshilli Fiskal i Serbisë në raportin e vitit 2022. Po ashtu, nuk është e qartë nëse të 3.100 punonjësit e këtyre ndërmarrjeve janë realisht të angazhuar çdo ditë.

Çfarë (nuk) bëjnë Termocentralet e Kosovës?

Termocentralet e Kosovës janë të regjistruara brenda sistemit energjetik serb si kompani për prodhimin e energjisë elektrike, edhe pse nuk kanë asnjë kontroll mbi termocentralet në territorin e Kosovës. Kjo kompani ka mbi 770 të punësuar, të cilët, sipas raporteve financiare, merren kryesisht me punë remonti dhe mirëmbajtjeje për sektorë të ndryshëm të EPS-it. Në listën e të punësuarve të kësaj kompanie përfshihen edhe 88 punëtorë nga ndërmarrjet publike të Kosovës, të themeluara brenda sistemit paralel serb, të cilat autoritetet zyrtare në Prishtinë i konsiderojnë të

paligjshme. Por, çfarë punojnë konkretisht këta punëtorë dhe ku janë të angazhuar? Këtyre pyetjeve të Radios Evropa e Lirë, kompania nuk iu përgjigj.

EPS-i është financuesi i vetëm i Termocentraleve të Kosovës - vetëm për paga dhe shpenzime të tjera thelbësore ka paguar 13.7 milionë euro, ndërsa për shërbimet që kompania kryen për sektorin energjetik serb, janë transferuar rreth 2.5 milionë euro të tjerë.

Megjithatë, Termocentralet e Kosovës prej vitesh punojnë me humbje.

Këto humbje, ndër të tjera, justifikohen me borxhet nga kreditë e huaja të marra para vitit 1999, si dhe me pamundësinë për të përdorur pronën në territorin e Kosovës. Në fund të vitit 2024, humbjet totale të Termocentraleve të Kosovës kapnin vlerën e mbi 355 milionë eurove, duke e renditur këtë kompani në vendin e dhjetë të ndërmarrjeve më të mëdha humbëse në Serbi.

Ndërkohë, kjo kompani gjatë vitit 2025 ka lidhur 50 marrëveshje dhe kontrata me kompani private dhe shtetërore në Serbi, me vlerë mbi 970 mijë euro.

Janë blerë gjithashtu materiale dhe mjete të ndryshme pune, janë paguar trajnime profesionale dhe kontrollë mjekësore për punëtorët, si dhe mirëmbajtja e pajisjeve. Kontrata më e vlefshme - mbi 180 mijë euro - i është dhënë një kompanie private, e cila është përgjegjëse për furnizimin me veshje dhe pajisje mbrojtëse. Kompania nuk kishte konkurrencë, pasi ishte e kishme që aplikoi në konkurs.

Ndër marrëveshjet e nënshkruara ishte edhe një kontratë me Telekomin e Serbisë, për shërbime dyvjeçare të telefonisë mobile, me vlerë mbi 57 mijë euro. Telekom i ishte po ashtu ofertuesi i vetëm.

Termocentralet e Kosovës nuk iu përgjigjën pyetjeve të Radios Evropa e Lirë lidhur me mënyrën e funksionimit dhe tenderët që shpallin.

Çfarë (nuk) bëjnë Minierat Sipërfaqësore të Kosovës?

Nxjerrja e linjitit dhe qymyrit është regjistruar si aktivitet i ndërmarrjes Minierat Sipërfaqësore të Kosovës, edhe pse - për më shumë se 25 vjet - ajo nuk ka kontroll mbi minierat e Kosovës.

Sot, sipas raportit financiar, ndërmarrja ka mbi 1.900 punonjës.

Siç thuhet, një pjesë e madhe e tyre kryen detyra shërbimi për kompanitë e Elektroprivredës së Serbisë - për shembull, riparojnë dhe mirëmbajnë objektet termoenërgjitime dhe lexojnë matësit e energjisë.

Gjatë vitit 2024, EPS-i i ka transferuar kësaj kompanie mbi 50 milionë euro - 41.7 milionë euro për pagat e punonjësve dhe për shpenzimet e funksionimit të

Punësimet e reja

Edhe pse objektiv zyrtar është ulja e numrit të punëtorëve, tri ndërmarrjet e EPS-it me seli në Kosovë, gjatë vitit 2024, kanë pranuar punonjës të rinj me kontrata të përhershme - nga dhjetë në Termocentralet e Kosovës dhe Minierat Sipërfaqësore të Kosovës dhe 18 të tjerë në Elektrokosmet, tregojnë raportet financiare. “Kjo bëhet për arsye populiste. Ju i mbani këta njerëz të punësuar brenda një sistemi të madh. EPS-

ndërmarrjes. Për punët ku EPS e ka angazhuar këtë kompani, janë transferuar edhe 8.4 milionë euro shtesë.

Në fund të vitit 2024, Minierat Sipërfaqësore të Kosovës shënuan një rezultat pozitiv, me fitim prej 1.4 milion eurosh.

Por, përveç performancës pozitive, në llogaritë e tyre janë grumbulluar edhe humbje nga vitet e mëparshme.

Kështu, Minierat Sipërfaqësore të Kosovës janë renditur në vendin e 49-të mes ndërmarrjeve më humbëse në Serbi, me më shumë se 111 milionë euro borxhe.

Borxhet justifikohen me detyrimet e prapambetura për kredi të huaja, të marra para vitit 1999, si dhe me faktin që ndërmarrja nuk e ka në dispozicion pronën në Kosovë. Por, borxhet e prapambetura nuk e pengojnë që të operojë në Serbi.

Në portalin e prokurimeve publike janë të regjistruara 23 kontrata dhe marrëveshje që Minierat Sipërfaqësore të Kosovës i kanë lidhur gjatë vitit 2025 me kompani shtetërore dhe private. Vlera e këtyre punëve tejkalon tre milionë euro.

Përmes tenderëve, kompania ka blerë materiale ndërtimi, veshje pune dhe pajisje mbrojtëse, si dhe kompjuterë dhe sisteme për digjitalizimin e arkivave.

Sipas kontratave, parku i automjeteve është duke u përditësuar gjithashtu dhe blerja e minibusëve, kamionëve dhe makinave i është dhënë kompanisë së njëjtë private që ka qenë e vetmja që ka aplikuar në konkurs.

Kontrata më e vlefshme iu dha Industrisë së Naftës së Serbisë.

Kompania është ngarkuar me blerjen e karburanteve në vlerë mbi 1.5 milion euro.

Ajo ishte e vetmja që aplikoi në këtë konkurs.

Minierat Sipërfaqësore të Kosovës nuk iu përgjigjën pyetjeve të REL-it rreth veprimtarisë së tyre dhe tenderëve që shpallin.

Çfarë (nuk) bën Elektrokosmet?

“Partner i besueshëm dhe shtyllë mbështetëse në furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike në pjesën veriore të

i është një rezervuar gjigant votash për çdo pushtet, përfshirë edhe këtë”, thotë Gjukiq.

Lëvizja opozitare në Serbi “Kreni-promeni” i ka renditur Termocentralet e Kosovës dhe Minierat Sipërfaqësore të Kosovës në mesin e ndërmarrjeve publike ku, sipas saj, punonjësit kanë raportuar presione, kërcënime dhe shantazhe nga drejtuesit.

Sipas pretendimeve të tyre, punonjësve u është kërkuar -

Kosovës” - ky është përshkrimi në faqen zyrtare të kompanisë Elektrokosmet.

Megjithatë, në Kosovë kjo nuk funksionon prej kohësh.

Sipas të dhënave nga raportet financiare të kompanisë, furnizimi me energji elektrike në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës është bërë nga kjo kompani deri në dhjetor të vitit 2020.

Autoritetet e Kosovës e kanë konsideruar atë si të paligjshme, pasi Elektrokosmet nuk kishte lejen përkatëse për veprimtarinë. Furnizimin dhe faturimin e energjisë në komunat veriore e ka marrë në dorë kompania Elektroseven në vitet e fundit.

Ajo është në pronësi të Elektroprivredës së Serbisë, por është e regjistruar sipas sistemit të Kosovës dhe funksionon sipas ligjeve të Kosovës - çfarë edhe është një nga pikat e

Marrëveshjes për Energetikën midis Prishtinës dhe Beogradit. Në fillim të vitit 2024, Elektroseven nisi t'i dërgonte faturat e para të energjisë elektrike për konsumatorët në katër komuna: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

Më herët, banorët e këtyre komunave nuk kanë paguar për energjinë elektrike për rreth 25 vjet. Arsyeja përse Elektrokosmet vazhdon të funksionojë brenda sistemit serb dhe shpall tenderë, edhe pse vetë kompania pranon se nuk kontrollon më kapacitetet e energjisë elektrike në Kosovë, nuk i është shpjeguar Radios Evropa e Lirë.

Borxhe milionëshe për Elektrokosmetin

Sipas raportit të fundit financiar për vitin 2024, Elektrokosmet gjeneron pjesën më të madhe të të ardhurave nga ofrimi i shërbimeve për degët e Elektroprivredës serbe.

Kompania ka 441 të punësuar. Sipas raportit, punonjësit janë të angazhuar në leximin e matësve të energjisë në Beograd dhe Nish, në kontrollin e stacioneve matëse, në sportelet e EPS-it dhe në punë të tjera ndihmëse.

Megjithatë, vit pas viti, Elektrokosmet shënon humbje në bilancin financiar.

Raporti financiar për vitin 2024

nën kërcënimin e humbjes së vendit të punës - të marrin pjesë në tubimet e Partisë Përparimtare Serbe (SNS), në kohën kur presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, përballet me protesta të mëdha antiqeveritare.

Radio Evropa e Lirë nuk ka arritur t'i verifikojë në mënyrë të pavarur këto pretendime, ndërsa SNS-ja nuk ka kthyer përgjigje deri në publikimin e këtij artikulli.

tregon se kompania ka përfunduar vitin me një humbje prej 12.4 milionë eurosh.

Humbja totale e Elektrokosmetit është shumë më e madhe - 115.5 milionë euro, për shkak të borxheve të grumbulluara ndër vite.

Në të njëjtin raport, Elektrokosmet i justifikon borxhet me arsye “politike” dhe me “përqindje të lartë të humbjeve komerciale dhe teknike”.

Më shumë se një milion euro për tenderët e Elektrokosmetit

Edhe pse ka humbje dhe nuk kryen aktivitetet për të cilat është themeluar, Elektrokosmet vazhdon të blejë pajisje dhe të paguajë shërbime për kompani të ndryshme në Serbi përmes tenderëve.

Sipas të dhënave të publikuara në portalin e prokurimeve publike, gjatë vitit 2025, Elektrokosmet ka lidhur kontrata me vlerë mbi një milion euro.

Më e vlefshmja ka qenë marrëveshja me Industrinë e Naftës së Serbisë - një kontratë dyvjeçare për furnizime me karburante për automjetet zyrtare, me vlerë afërsisht 770 mijë euro.

Industria e Naftës e Serbisë ishte e vetmja që iu përgjigj këtij tenderi. Gjatë vitit 2025, Elektrokosmet lidhi marrëveshje dyvjeçare edhe me disa kompani private për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve, me vlerë rreth 350 mijë euro. Katër kompanitë që i fituan këto punë, ishin të vetmet që aplikuan në tender.

Degë të tjera të regjistruara të Elektrokosmetit në Kosovë

Përveç selisë në Beograd, Elektrokosmet ka të regjistruar në Regjistrin Ekonomik të Serbisë edhe tetë degë të tjera në Kosovë. Dega në Mitrovicë është regjistruar në adresën “Filip Vishnjiq bb”, ku ndodhet selia e firmës Elektroseven në sistemin kosovar.

Dy degë janë të regjistruara në Prishtinë, dhe nga një në Gjakovë, Prizren, Gjilan, Pejë dhe Ferizaj. Megjithatë, në këto qytete nuk

ekzistojnë degë të firmave shtetërore serbe.

Shumica e ndërmarrjeve dhe institucioneve publike që veprojnë në sistemin paralel serb, të cilat Prishtina i ka konsideruar të paligjshme, janë mbyllur në Kosovë dhe janë zhvendosur në Serbi.

Adresat kosovare të kompanive të EPS-it - “vetëm në letër”

Sipas të dhënave nga Regjistri Ekonomik i Serbisë, selitë e dy ndërmarrjeve të EPS-it - Minierat Sipërfaqësore të Kosovës dhe Termocentralet e Kosovës - janë të shënuara brenda kompleksit elektroenergjitik në Obiliq, pranë Prishtinës.

Në këto lokacione ndodhen sot objektet e Korporatës Energetike të Kosovës.

Por, në fakt, këto dy kompani të EPS-it operojnë nga adresat e tyre në Beograd.

Selia e Termocentraleve të Kosovës ndodhet në qendër të Beogradit, në adresën “Obiliqev venac”, ndërsa selia e Minierave Sipërfaqësore të Kosovës është në lagjen Çukarica të Beogradit.

Kompania e tretë e EPS-it, Elektrokosmet, pretendon se ka seli në Prishtinë.

Ajo është e regjistruar në adresën “Krala Petra I Oslobodioca” - një rrugë që nuk ekziston më me këtë emër, pasi tani mban emrin e ish-presidentit amerikan, Bill Clinton. Sot, aty gjendet kompania kosovare për shpërndarjen e energjisë elektrike - KESCO. Ndërsa, selia e Elektrokosmetit në Beograd është e regjistruar në rrugën “Arçibalda Rajsa”, në lagjen Çukarica.

Thirrje për reformimin e EPS-it

Edhe pse, si kompania më e madhe shtetërore, regjistrojnë të ardhura milionëshe nga prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike, EPS-i mbetet njëkohësisht edhe firma me humbjet më të mëdha në Serbi.

Sipas të dhënave të Agjencisë për Regjistrin e Bizneseve, në vitin 2024, EPS-i ishte firma më e suksesshme në Serbi, me të ardhura mbi 200 milionë euro. Megjithatë, humbjet e akumuluar nga vitet e mëparshme, në vlerë prej 2.4 miliardë eurosh, e renditën atë edhe në vendin e parë për nga humbjet më të mëdha.

Reformimin e EPS-it nga Qeveria e Serbisë e ka kërkuar edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, me qëllim zvogëlimin e humbjeve.

Në raportin për vitin 2024, EPS-i njoftoi se reforma është në zhvillim, duke u zbatuar në bashkëpunim me konsulentë ndërkombëtarë dhe ekipe profesionale vendase.

Qëllimi, sipas EPS-it, është të përmirësohet efikasiteti dhe të rritet transparenca në menaxhimin e kompanisë.

Sa u përket reformave për kompanitë me seli të regjistruara në Kosovë, EPS-i nuk i ka kthyer përgjigje Radios Evropa e Lirë.



SAINT-GOBAIN
SEKURIT

PILKINGTON

Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Monitimi

Servisi

Perfekt



QENDRA SPORTIVE

'BUJQËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Asllani: Fokusi im i plotë është tek Hoffenheimi

Hoffenheim, 8 dhjetor - Sulmuesi i Kombëtares së Kosovës, Fisnik Asllani ka folur për herë të parë rreth spekulimeve për të ardhmen e tij. Asllani është pjesë e Hoffenheimit, ndërsa kohët e fundit interesim për transferimin e

tij, kanë shfaqur Bayern Muncheni, Borussia Dortmundi e Barcelona. 23-vjeçari ka treguar formë të mirë këtë sezon, ku në 15 paraqitje ka shënuar 6 gola dhe ka bërë 3 asistime. Ai ka thënë se sigurisht që ka dëgjuar për spekulimet,

ndërsa ka shkuar se ndihet krenar me emrat e skuadrave që kanë shprehur interesim për transferimin e tij. “Fokusi im i plotë është tek Hoffenheimi dhe kjo është gjëja më e rëndësishme. Do të shohim se çka do të ndodhë në fund

të sezonit”, ka deklaruar Asllani. Sulmuesi ka kontratë me skuadrën e Hoffenheimit deri në verën e vitit 2029, ndërsa thuhet se ka një klauzolë lirimi në vlerë prej 30 milionë eurosh për t’u larguar verën e ardhshme.



BALLKANI SHKËPUTET NË KRYE TË TABELËS NË SUPERLIGË

Prishtinë, 8 dhjetor - Albi Mall Superliga e Kosovës ka dhuruar emocione dhe gola në ndeshjet e xhiros së 16-t. Ballkani e ka përforcuar pozitën e parë në renditje, me fitore bindëse para tifozëve të vet ndaj Prishtinës së Re, me shifrat 6:1. Pas kësaj fitoreje, Ballkani kryeson në tabelë me 29 pikë, ndërsa Prishtina e Re mbetet e fundit me 14 pikë. Një dramë e vërtet është zhvilluar në stadiumin “13 Qershori” në Klinë. Dukagjini ishte pranë fitores, por Drita ka barazuar në fund falë golit

të Besnik Krasniqit në minutën e 94-t. Me këtë barazim, Dukagjini ngjitet përkohësisht në vendin e dytë me 27 pikë, ndërsa Drita bie në pozitën e pestë me 24 pikë, duke pasur ende një ndeshje më pak të zhvilluar. Malisheva ka vazhduar me formë të mirë, duke realizuar fitoren e katërt radhazi. Kësaj radhe duke e mposhtur Drenicën në “Liman Gegaj”, 2:0. Malisheva mban vendin e katërt me 25 pikë, ndërsa Drenica mbetet në zonën e barazhit, në vendin e tetë me



17 pikë. Prishtina nuk ka arritur të rikthehet te fitorja as në ndeshjen e dytë nën drejtimin e Afrim Tovërlanit, duke u ndalur në barazim 1:1 ndaj Ferizajt. Kjo është ndeshja e

pestë rresht në kampionat pa fitore për bardhekaltrit e kryeqytetit, të cilët kanë regjistruar tri humbje dhe dy barazime në këtë periudhë. Prishtina mbetet e dyta me 27 pikë dhe një ndeshje më pak të zhvilluar, ndërsa Ballkani kryeson me dy pikë më shumë. Ndërsa Gjilani ka hyrë në një seri pozitive, duke shënuar fitoren e tretë rresht në të gjitha garat. Skuadra e Debatik Currit ka triumfuar 3:0 ndaj Llapit, në një ndeshje ku ka dominuar plotësisht, sidomos në pjesën e dytë. Me

SUPERLIGA, RENDITJA TABELARE	
Ballkani	29
Prishtina	27
Dukagjini	27
Malisheva	25
Drita	24
Gjilani	22
Llapi	20
Drenica	17
Ferizaj	16
Prishtina e Re	14

këtë fitore, Gjilani ngjitet në pozitën e gjashtë me 22 pikë, ndërsa Llapi zbret në vendin e shtatë me 20 pikë.

ARLIND VELIU I MALISHEVËS SHPALLET “YLLI I JAVËS” NË SUPERLIGË



Prishtinë, 8 dhjetor - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), në bashkëpunim me sponzorin zyrtar të Superligës, Albi Mall, ka shpallur këtë javë fituesin e çmimit tradicional “Ylli i Javës”, i dedikuar futbollistit më të dalluar të javës në elitën e futbollit kosovar. Për javën e gjashtëmbëdhjetë të këtij edicioni, ky çmim i është dhënë futbollistit të FC

Malisheva, Arlind Veliu, i cili shfaqti një paraqitje të shkëlqyer gjatë 90 minutave të ndeshjes së fundit. Ndonëse është mbrojtës, Veliu ka shënuar dy gola vendimtarë në fitoren 2:0 të skuadrës së tij kundër FC Drenica. Vlerësimi është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit dhe u shpall zyrtarisht këtë javë, raporton

Klankosova.tv. Pasi ka marrë këtë çmim, Veliu është shprehur i lumtur që është vlerësuar si lojtari më i mirë i javës. “Nuk e kemi nisur kampionatin në mënyrën më të mirë, por megjithatë me trajnerin e ri po mundohemi të përmirësojmë lojën dhe të kuptojmë filozofinë e tij. Ambiciet tona janë tre vendet e para të tabelës dhe dalja në

Evropë. E kemi ditur që kemi pasur një ndeshje të vështirë kundër Drenicës dhe mendoj se ia kemi dalë ta përgatisim mirë dhe të shënojmë fitore. Në aspektin personal, gëzohem që kam mundur të ndihmoj ekipin me dy gola dhe për këtë i falënderoj bashkëlojtarët e mi për angazhimin”, ka thënë Veliu për faqen zyrtare të FFK-së.

ALONSO DREJT SHKARKIMIT, CITY RASTI I FUNDIT

Madrid, 8 dhjetor - Xabi Alonso mund të shkarkohet nga posti i trajnerit të Real Madridi gjatë kësaj jave, kanë njoftuar të hënën mediumet spanjolle. Humbja nga Celta Vigo në

ndeshjen e fundit kampionale, ka bërë që bordi i klubit madrilen ta njoftojë Alonson se i duhet patjetër fitorja ndaj Manchester Cityt për t’i shpëtuar shkarkimit. Real

Madridi ka vetëm dy fitore në shtatë ndeshjet e fundit, ndërsa të mërkurën mbrëma do të përballlet me Manchester Cityn në Ligën e Kampionëve, përballje kjo që luhet në

stadiumin “Santiago Bernabeu”. Është bërë me dije se Real Madridi, tashmë ka nisur të hulumtojë tregun e trajnerëve dhe dy janë në listë të ngushtë për të zëvendësuar Alonson,

Zinedine Zidane dhe Jurgen Klopp. Alonso ka marrë drejtimin e Real Madridit para fillimit të këtij sezoni ka kontratë valide deri në verën e vitit 2028.

Liverpooli dhe Slot e përjashtojnë Salahun për ndeshjen me Interin

Liverpool, 8 dhjetor - Përplasja mes Mohamed Salahut dhe klubit vijon të thellohet. Sipas asaj që raporton RMC Sport, e cituar nga gazetari i njohur Fabrizio Romano, sulmuesi egjiptian është lënë jashtë skuadrës për ndeshjen e Ligës së

Kampionëve kundër Interit që luhet sot (e martë). Vendimi është marrë nga drejtuesit e Liverpoolit në bashkëpunim me trajnerin Arne Slot. Ky zhvillim vjen pas disa javësh tensioni. Salah i ka nisur tre ndeshjet e fundit të Ligës Premier nga stoli,

ndërsa në barazimin e fundjavës kundër Leeds nuk u aktivizua fare. Situata ka sjellë pakënaqësi të hapur nga ana e futbollistit. Së fundmi, Salah ka deklaruar se marrëdhënia e tij me trajnerin Slot është përkeqësuar dhe se ndien se klubi nuk po e trajton

drejt. “Është e qartë se dikush dëshiron që unë të marr të gjithë fajin. Kam thënë disa herë se kam marrëdhënie të mirë me trajnerin, dhe tani papritmas duket sikur nuk kemi asnjë marrëdhënie. Nuk e kuptoj pse”, ka thënë Salah.



Interi del nga kriza financiare me bilanc pozitiv dhe të ardhura historike



FODA: PO ZHVILLOHEN BISEDIMET PËR KONTRATËN E RE, MUND TË QËNDROJ MË GJATË TE KOSOVA



F2.3/BNJ



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM "Pastrimi" Sh.A. konkretisht neni 11, paragrafi 1.2 dhe neni 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve me nr. protokollit 01/14/37 të datës 02/09/2025, bazuar në Vendimin e KE-së me nr. protokollit 02/01/670 të datës 29/08/2025, bazuar në Vendimin e KE-së për pozitën test me nr. protokollit 7096 të datës 15/11/2024, bazuar në Vendimin e datës 05.12.2025 me numër të protokollit 02/01/892 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK PA TEST (KP/PT)

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i Vendit të punës: " Punëtor i Bartjes"
Nr. i kërkuar: Pesëmbëdhjetë (15) pozita, NJO Prishtinë në KRM "Pastrimi" SH.A
Numri i Referencës: KB/PT/NJO-PR/40-2025
Koeficienti/Paga mujore: Niveli XIII
Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar
Periudha Provuese: 3 muaj

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- 1.1 Bënë mbledhjen e mbeturinave në zonat e caktuara;
- 1.2 Bënë zbrazen e kontejnerëve në automjet/kamion;
- 1.3 Bënë pastrimin e zonës përreth kontejnerëve;
- 1.4 Bazuar në planin operativ dhe urdhëresës së punës bëjnë pastrimin dhe larjen e rrugëve dhe trotuareve;
- 1.5 Bënë pastrimin e trotuareve dhe rrugëve nga bora dhe hujtjen e kripës;
- 1.6 Bënë largimin e kafshëve të ngordhura nga rruga dhe vendosjen e tyre në kontejnerin përkatës;
- 1.7 Është përgjegjës për mirësjellje ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të kompanisë;
- 1.8 Është përgjegjës që pas mbledhjes së mbeturinave, kontejnerët të vendosë në vendin paraprak;
- 1.9 Kujdeset dhe është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të mjeteve të punës dhe kontejnerëve;
- 1.10 Kryen edhe punë të tjera me të cilat e angazhon udhëheqësi;
- 1.11 Për punën e tij i raporton Kryepuntorit të Bartjes në Njësi Operative.

2. Kriteret e përgjithshme për praninë në detyrë:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të zotërojë të paktën një gjuhë zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- ✓ Të ketë aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në ligj.

3. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- ✓ Të jesh i kujdesshëm dhe t'i kushtosh vëmendje detajeve;
- ✓ Aftësia për të punuar vetë;
- ✓ Aftësitë e shërbimit ndaj klientit;
- ✓ Njohuri për sigurinë publike;
- ✓ Aftësia për të punuar mirë me duart e tua;
- ✓ Formë fizike dhe qëndrueshmëri;
- ✓ Aftësia për të organizuar kohën dhe ngarkesën e punës;
- ✓ Aftësi të mira të komunikimit verbal.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

Kërkesa për punësim dhe CV-ja, e plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati	✓
Dëshmi të kualifikimeve shkollore nga Institucionet Arsimore (e dëshirueshme)	✓
Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës)	
Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme)	✓
Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme)	✓
Dokument identifikimi i Republikës së Kosovës	✓
Vërtetimi nga Gjykata që personi nuk është nën hetime, JO më të vjetër se 6 muaj	✓

5. Mënvera e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:

5.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:

* duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A.
* në recepcionin e kompanisë.

5.2 Dorëzimi i aplikacionit:

* Kërkesa për punësim, me dokumentacionin e kompletuar bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com në formatin PDF dhe
* Në rastet e konkurseve të brendshme dhe jashtme për pozitën teknike mund të bëhet edhe në formë fizike nëpërmjet Arkivës së kompanisë.

6. Data dhe ora e saktë e mbvlljes së Konkursit Publik:

Konkursi Publik zgjatë 8 ditë nga data 09/12/2025 deri me datën 23/12/2025
Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.
Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

7. Mënvera e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të:

- ✓ CV-së së kandidatit: deri në 25 pikë
- ✓ Intervistimi: deri në 75 pikë.

8. Mënvera e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimit elektronit dhe individualisht.

9. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;
Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,
Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.
Publikimi i rezultateve bëhet deri në 3 ditë pas vlerësimit të intervistës.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.



F2.3 /



REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" A.D

Na osnovu Zakona o radu br. 03 / L-212, posebno član 8, u Uredbi br. 07/2024 o radnom odnosu u RPO "Pastrimi" a.d. konkretno, član 11. stav 1.2 i član 12, u Uredbi br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RPO "Pastrimi" a.d. A, na osnovu Odluke Upravnog odbora sa br. Protokol 01/14/37 od 02/09/2025, na osnovu Odluke EK br. Protokol 02/01/670 od 29.08.2025. godine, na osnovu Odluke EK o ispitnim pozicijama br. protokol 7096 od 15.11.2024. godine, zasnovan na Odluci od 05.12.2025. godine sa brojem protokola 02/01/892 izvršnog direktora RPO "Pastrimi" A.D, objavite ovo:

JAVNO TAKMIČENJE BEZ TESTA (KP/PT)

Za popunjavanje posla

Naziv posla: " Radnik Prenosa"
Ne. Potreban: Petnaest (15) pozicija, NJO Priština u RPO "Pastrimi" A.D
Referentni broj: KB/PT/NJO-PR/40-2025
Koeficijenti/Mesečna plata: Nivo XIII
Trajanje ugovora o radu: Na neodređeno vreme
Probni period: 3 meseca

1. Dužnosti i odgovornosti:

- 1.1 Sakupljali su otpad u određenim oblastima;
- 1.2 Pražnjenje kontejnera u vozilo / kamion;
- 1.3 Očistili su područje oko kontejnera;
- 1.4 Na osnovu operativnog plana i radnog naloga, čistili su i prali ulice i trotoare;
- 1.5 Očišćeni trotoari i ulice od snega i bauao so;
- 1.6 Uklonili su mrtve životinje sa puta i stavili ih u odgovarajući kontejner;
- 1.7 Odgovoran je za ljubaznost prema građanima i korisnicima usluga kompanije;
- 1.8 Odgovorno je da kontejnerne postavi na prethodno mesto nakon sakupljanja otpada;
- 1.9 Brine i odgovoran je za pažljivo korišćenje radnih alata i kontejnera;
- 1.10 Obavlja i druge zadatke kojima se voda bavi;
- 1.11 Izveštava o svom radu glavnom službeniku za transfer u Operativnoj jedinici.

2. Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:

- ✓ Budite državljanin Republike Kosovo,
- ✓ da poznaje najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Biti u stanju da obavlja relevantan zadatak;
- ✓ Ne biti osuđen za počinjenje krivičnog dela;
- ✓ Ne bi trebalo da postoji disciplinska mera na snazi za ozbiljan prekršaj u javnoj ustanovi;
- ✓ Imajte veštine potrebne za poziciju
- ✓ Da uspešno prođe procedure prijema utvrđene u zakonu.
- ✓ biografije kandidata: do 25 bodova
- ✓ Intervjuisanje: do 75 bodova.

8. Način obaveštavanja i komunikacije sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavesteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

9. Približan kalendar postupka zapošljavanja:

Faza prethodne verifikacije prijava do 7 dana;
Pismena faza testiranja do 10 dana nakon faze verifikacije,
Faza intervjuja do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.
Objavljivanje rezultata vrši se do 3 dana nakon evaluacije intervjuja.

Napomena: Nepotpuni, neskenirani dokumenti, kao i oni koji stignu nakon isteka roka za dostavu konkursa, neće biti pregledani.



F2.3/BNJ



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "PASTRIMI" SH.A
Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM "Pastrimi" Sh.A. konkretisht neni 11, paragrafi 1.2 dhe neni 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve me nr. protokollit 01/14/37 të datës 02/09/2025, bazuar në Vendimin e KE-së me nr. protokollit 02/01/670 të datës 29/08/2025, bazuar në Vendimin e KE-së për pozitën test me nr. protokollit 7096 të datës 15/11/2024, bazuar në Vendimin e datës 05.12.2025 me numër të protokollit 02/01/892 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë kët:

**KONKURS PUBLIK PA TEST (KP/PT)
Për plotësimin e vendit të punës**

Titulli i Vendit të punës: "Shofer i kategoris B"
Nr. i kërkuar: Një (1) pozita, NJO Prishtinë në KRM "Pastrimi" SH.A
Numri i Referencës: KB/PT/NJO-PR/41-2025
Koeficienti/Paga mujore: Niveli XI
Përvoja e punës: 2 vite përvojë pune në fushën përkatëse
Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: Me kohë të pa caktuar
Periudha Provuese: 3 muaj

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- 1.1 Nget automjetin për kryerjen e punëve sipas urdhëresës së punës;
- 1.2 Kujdesit për rregullsinë dhe pastërtinë e automjetit;
- 1.3 Mban evidencën për punët e kryera duke u kujdesur që me kohë t'i kryen shërbimet sipas planit dhe urdhëresës së punës;
- 1.4 Në rast nevojë ndërron gomat në teren dhe në punëtorinë e makinave në bashkëpunim me gomisterin;
